



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim A-B/B-A (1)**

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 60 seminare

Viti / Semestri: Viti III / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Në përfundim të modulit është i mundur Përcaktimi i strategjisë së përkthimit. Njohja e studentit me nocionet bazë të përkthimit dhe me ligjësitë e procesit përkthimor Përcaktimi i strukturës përmbajtësore të origjinalit dhe segmentimi i tekstit në njësi përkthimore. Analiza e strukturave sintaksore të ndërlikuara. Përzgjedhja e barasvlerësit përkthimor në varësi nga veçoritë e sistemit dhe normave gjuhësore të rusishtes dhe shqipes.

Objektivat specifike lëndore:

Në përfundim të modulit studenti duhet:

1. Të zhvillojë shprehjet praktike, kryesisht në përkthimet nga gjuha ruse në gjuhën shqipe.
2. Të zhvillojë të kuptuarit e fjalës në vartësi nga konteksti i përdorimit të saj.
3. Të përdorë transformimet në përkthim dhe të përcaktojë masën optimale të përdorimit të tyre.
4. Të përcaktojnë përkimet dhe dallimet mes gjuhëve gjatë ballafaqimit të të dy sistemeve gjuhësore.